

HARTËZIMI DHE SFIDAT E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE NË KOSOVË

2022

Linda Abazi Morina

HARTËZIMI DHE SFIDAT E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE NË KOSOVË

2022



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD), një projekt i Fondit Marshal Gjerman të SHBA-së (GMF) përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga CIVIKOS. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Trustit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të SHBA-së, USAID-it apo Qeverisë së SHBA-së.

Raporti i plotë përfshin anekse me informacion të detajuar si kapacitetet, lloji i shërbimit dhe nevojat e OSHC-ve individuale të ofruesve të shërbimeve. CiviKos do të përdorë të dhënat e nxjerra nga anekset gjatë procesit të bërjes së rekomandimeve të politikave për kontraktimin e shërbimeve.

Ky version për publikim nuk përfshin këto anekse.

TABELA E PËRMBAJTJES

7	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
8	Gjetjet kryesore
9	Rekomandimet kryesore
10	HYRJE
10	Politikat dhe kornizat ligjore
11	Procesi i licencimit dhe praktikat e financimit publik për OJQ-të
13	GJETJET E HULUMTIMIT
13	Të dhëna përshkruese
14	Financimi nga shteti për shërbimet sociale
16	Pandemia e Covid-19 dhe ndikimi i saj në shërbimet dhe financimet
17	Gjetjet nga seminari verifikues
21	HARTËZIMI I ORGANIZATAVE QË OFROJNË SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE
21	Strehimoret për viktimat e dhunës në familje dhe ofrues të tjerë të shërbimeve rezidenciale
22	Organizatat që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijët në nevojë
23	Organizatat që ofrojnë shërbime jorezidenciale sociale dhe familjare
24	Organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rriturit me nevoja të veçanta
25	Organizatat që ofrojnë shërbime kryesisht për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian
26	Organizatat e tjera
26	KONKLuzionet dhe Rekomandimet

LISTA E FIGURAVE

- | | |
|----|--|
| 13 | Figura 1 |
| | Shpërndarja e punës së organizatës në komuna |
| 14 | Figura 2 |
| | Cili ishte buxheti vjetor i organizatës në vitin 2021 |
| 15 | Figura 3 |
| | Si do ta përshkruanit natyrën e mbështetjes së qeverisë për organizatën tuaj? |
| 16 | Figura 4 |
| | Si ndikoi pandemia COVID -19 në financimin tuaj nga qeveria? |
| 16 | Figura 5 |
| | Kërcënimet kryesore për organizatën tuaj për shkak të kufizimeve të COVID -19 |
| 17 | Figura 6 |
| | Çfarë lloj mbështetjeje ju nevojitet për të vazhduar punën sipas kufizimeve aktuale të Covid-19? |
| 17 | Figura 7 |
| | Cilat janë mundësitë që dalin nga pandemia COVID-19? |

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) luajnë një rol kritik në ofrimin e shërbimeve sociale në Kosovë, veçanërisht në fushat ku institucioneve shtetërore u mungojnë kapacitetet për të adresuar nevojat. Gjatë dy dekadave të fundit, profili i OSHC-ve është rritur ndjeshëm dhe janë njohur si nga qeveria ashtu edhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Pavarësisht punës së tyre të rëndësishme dhe rritjes së kërkesave, organizatat ofruese të shërbimeve janë përballur me vështirësi të ndryshme për të përmbushur misionin e tyre, veçanërisht që nga fillimi i pandemisë COVID-19. Prandaj, qëllimi parësor i këtij hulumtimi është të identifikojë dhe analizojë sfidat dhe nevojat e organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për përfituesit e tyre, me fokus në ndikimin e pandemisë COVID-19 në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Pjesa e parë e hulumtimit bazohet në një anketë që CIVIKOS ka realizuar me disa nga organizatat ofruese të shërbimeve sociale. Në anketë morën pjesë gjithsej 35 organizata, ofruese të shërbimeve. Anketa ka mbledhur informata mbi strukturën, personelin dhe buxhetin vjetor të këtyre organizatave dhe mbuloi financimet e shtetit për shërbimet sociale, dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në shërbimet dhe financimet.

Pjesa e dytë e këtij hulumtimi synon hartëzimin e organizatave ofruese të shërbimeve sociale, kryesisht organizata të licencuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tashmë e shkrire në Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Organizatat janë ndarë në disa kategori duke filluar nga organizatat që ofrojnë:

1. shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit;
2. shërbime rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror;
3. shërbimet sociale dhe familjare jo rezidenciale;
4. shërbime për fëmijët dhe të rriturit me nevoja të veçanta;
5. shërbimet kryesisht për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian; dhe
6. fushëveprimi paksa i ndryshëm i punës.

Ky hartëzim i praktikave ekzistuese bazohet në rishikimin e hulumtimeve ekzistuese, llojit të mbështetjes që OSHC-të u kanë ofruar përfituesve të tyre gjatë pandemisë COVID-19, nevojat specifike në kontekstin e pandemisë, si dhe llojin e ndihmës që kanë marrë nga qeveria e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve.

Synimet kryesore janë trajtimi i sfidave që dalin nga pandemia COVID-19, mësimet e nxjerra, dhe se si këto të fundit mund të kthehen potencialisht në veprime si dhe të ketë qëndrueshmëri më të mirë për situata të ngjashme në të ardhmen. Ky vlerësim është pjesë e projektit **Zbutja e ndikimit të pandemisë COVID-19 te OSHC-të që ofrojnë shërbime**, zbatuar nga Platforma CiviKos në partneritet me European Center for Not for-Profit Law Stichting (ECNL), si dhe financuar nga **Balkan Trust for Democracy, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe USAID**.

Gjetjet e këtij hulumtimi do të ndihmojnë me zbatimin e **Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023** dhe rregullimin e një sistemi të qëndrueshëm të kontraktimit të shërbimeve nga institucionet publike për organizatat që ofrojnë shërbime në Kosovë.

Të dhënat sasiore nga sondazhi janë koduar dhe analizuar duke përdorur SPSS-në (Paketa Statistikore për Shkencat Sociale). Për të përmbushur objektivat e hulumtimit është përdorur edhe hulumtimi nga zyra për të shqyrtuar dokumentet e politikave, kornizën ligjore dhe të dhëna të tjera të disponueshme lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Janë realizuar edhe takime personale për të vërtetuar gjetjet e hulumtimit. Në fund u organizua edhe një punëtori verifikuese me akterët kryesorë pjesëmarrës për të vërtetuar të dhënat dhe për të diskutuar rekomandimet.

Mbledhja e të dhënave për këtë hulumtim është organizuar gjatë periudhës shkurt-mars, 2022. Pas konsultimeve me përfaqësuesit e CiviKos u përpilua lista përfundimtare e organizatave, e cila përbëhet nga organizata të licencuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Në shkurt të vitit 2020, gjithsej 47 organizata ishin futur në bazën e të dhënave. Shtatë organizata të tjera iu shtuan listës si vlerë e shtuar e këtij hulumtimi. Pasi pyetësi ishte hartuar dhe pastaj miratuar nga CiviKos, ai u përkthye në gjuhën shqipe dhe serbe dhe iu dërgua të gjitha organizatave. Përveç kësaj, çdo organizatë është kontaktuar përmes telefonit për të siguruar shkallën sa më të lartë të përgjigjeve. Si rezultat, janë përgjigjur gjithsej 35 organizata, duke mbuluar 18 komuna të ndryshme të Kosovës.

Gjetjet kryesore të hulumtimit:

- Ofruesit kombëtar të shërbimeve kanë një fushëveprim të përcaktuar të qartë dhe janë të pozicionuar mirë për të ofruar shërbime për përfituesit e tyre.
- Shumica e organizatave që ofrojnë shërbime kanë më shumë se 20 vjet përvojë pune dhe numri mesatar i personelit, që punojnë me orar të plotë, janë në mes **katër dhe dhjetë** punonjës. Prandaj, këto organizata konsiderohen të qëndrueshme dhe profesionale për të ofruar shërbimet e tyre.
- Shumica e organizatave pjesëmarrëse në anketë kishin një buxhet mbi **60 mijë euro**. Tre burimet kryesore të financimit për organizatat ishin: **1) fondet nga donatorët ndërkombëtarë, 2) fondet nga Qeveria e Kosovës dhe 3) fondet nga pushteti lokal**. Nuk kishte dallim madhor në mes të organizatave nacionale dhe lokale në këtë drejtim.
- Sa i përket mbështetjes që ato marrin nga qeveria, 29 nga 35 organizata deklaruan se mbështetja e marrë është e pamjaftueshme. Mbështetja që ata marrin është kryesisht në formën e granteve afatshkurtra dhe ofrimin e hapësirave për zyra pa pagesë të qirasë (kryesisht nga niveli i qeverisjes lokale).
- Kurse sa i përket qëndrueshmërisë së tyre financiare, 25 organizata raportuan se nuk ishin të qëndrueshme financiarisht për të ofruar shërbime thelbësore afatgjate për përfituesit. Nga ky numër, 14 prej tyre raportuan se do të ishin në gjendje të ofrojnë shërbime për afërsisht 7-12 muaj.
- Shumica e organizatave (31) u përgjigjën se mbështetja e qeverisë është jetike; pa mbështetjen e qeverisë, ato nuk do të jenë në gjendje të mbijetojnë në periudhën afatgjate, ndërsa vetëm dy organizata raportuan se financimi i qeverisë nuk është jetik, por do të kontribuonte shumë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të tyre.
- Për shumicën e organizatave, mbështetja e qeverisë është jetike për mbijetesën e tyre në afat të gjatë. Mënyra më e mirë e qeverisë për të mbështetur organizatat është përmes kontratave afatgjate, ku qeveria i kontraktton ato për të ofruar shërbime specifike për përfituesit.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ofrimin e shërbimeve sociale

- Sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19 në shërbimet dhe financimin, shumica e organizatave raportuan rritje të kërkesës për shërbime.
- Kërcënimet kryesore të cilat janë identifikuar nga organizatat për shkak të kufizimeve të COVID -19 ishin mundësitë e kufizuara për të ofruar shërbime, të ndjekur nga kapacitetet e kufizuara për të përmbushur nevojat e rritura të përfituesve, si dhe kërcënimi për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e organizatës.
- Shumica dërrmuese e organizatave do të kishin nevojë për mbështetje financiare për të vazhduar punën në ofrimin e shërbimeve për përfituesit e tyre, edhe nëse organizatat vazhdojnë të funksionojnë nën kufizimet e COVID -19. Format e tjera të mbështetjes, të tilla si ngritja e kapaciteteve për personel për të përdorur vegla online, dhe kushtet bazë për të punuar nga distanca, si interneti dhe pajisjet, u vlerësuan si më pak të rëndësishme.
- Më shumë se gjysma e organizatave raportuan se mundësitë e tyre kryesore që dolën gjatë pandemisë COVID -19 ishin: 1) ide të reja për projekte, 2) dukshmëria më e mirë e punës së tyre dhe 3) imazhi i përmirësuar dhe besim më i lartë në punën e tyre.

REKOMANDIME KYÇE:

Për Qeverinë e Kosovës:

- Qeveria e Kosovës duhet të kontraktojë organizatat përmes angazhimit të tyre afatgjatë për ofrimin e shërbimeve specifike sociale dhe familjare për përfituesit. Sa i përket kësaj, qeveria duhet të angazhohet në dialog me OSHC-të për të vendosur lidhur me praktikën dhe modalitetet më të mira për angazhimin afatgjatë kontraktual të OShC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
- Qeveria duhet të mbulojë shpenzimet e shërbimeve për aktivitet/program në procesin e licencimit të organizatave. Tarifa e shërbimeve duhet të përfshijë të gjitha elementet e nevojshëm të shpenzimeve, duke përfshirë shërbimet për përfituesit, personelin, hapësirat e zyrave, pajisjet ndihmëse operacionale, etj.
- Qeveria nuk duhet të anashkalojë OSHC-të rishtazi të themeluara që mund të sjellin shkathtësi dhe kapacitete për të konkurruar me shërbimet e cilësisë së lartë.
- Qeveria duhet të përcaktojë instrumentet e standardizuara për të vlerësuar kapacitetet e organizatave dhe programet e tyre për të ofruar shërbime për përfituesit. Licenca duhet të dëshmojë se organizatat duhet të paraqesin dhe posedojnë një nivel të caktuar të cilësisë. Nën këtë prag të përcaktuar, ato nuk duhet të jenë në gjendje të rinovojnë licencën dhe të kenë të drejtë për marrëveshje kontraktuale me qeverinë.
- Qeveria duhet të angazhojë organizatat të jenë pjesë gjatë procesit të hartimit dhe planifikimit të marrëveshjeve kontraktuale afatgjata me qeverinë. Sa i përket kësaj, qeveria duhet t'u japë prioritet organizatave që punojnë me grupe të marginalizuara dhe të cënueshme, e që kanë nevojë për kujdes urgjent dhe shërbimet e të cilave nuk mund të vonohen, siç janë të mbijetuarit e dhunës në familje, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët që punojnë në rrugë, etj.

Për organizatat:

- Organizatat duhet që vazhdimisht të vlerësojnë nevojat e përfituesve përmes një vlerësimi të brendshëm të ofrimit të shërbimeve të tyre sociale dhe familjare. Këtu përfshihen diskutimet e ndikimit që ka puna tek organizatat dhe eksplorimin e ndikimit të saj tek përfituesit.

Rekomandime specifike që lidhen me COVID -19:

- Organizatat duhet të punojnë ngushtë me qeverinë në hartimin dhe planifikimin e masave mbështetëse të pandemisë COVID-19.
- Financimet nga qeveria duhet të përshtaten dhe drejtohen kah mbështetja dhe plotësimi i boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve, për organizatat që kanë raportuar rritje të kërkesës për shërbime, e të cilat duhet të vlerësohen dhe monitorohen nga afër.
- Organizatat duhet të krijojnë diçka të ngjashme si Procedurë Standarde të Veprimit, se si të veprojnë në rastet kur ka një rritje të fluksit të përfituesve në situata emergjente. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e nevojave të personelit për t'u përballuar me ndryshimet e papritura dhe për të vlerësuar aftësitë e tyre për t'u përshtatur me situatën e re.
- Organizatat duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të punuar në internet (online) dhe për të ofruar shërbime për përfituesit në internet (siç është këshillimi).

2. HYRJE

Sektori i OSHC-ve në Kosovë është zhvilluar në mënyrë dinamike, që nga paslufta. Të dhënat e fundit tregojnë se në Kosovë janë të regjistruara më shumë se 9500 organizata të shoqërisë civile (KCSF, 2018)¹. Numri i organizatave që kanë pasur ndonjë aktivitet financiar apo punësim gjatë vitit 2017 vlerësohet të jetë rreth 1000. Për më shumë, raporti vë në pah se pothuajse gjysma e OJQ-ve në Kosovë veprojnë pa asnjë financim (46%), ndërsa pjesa tjetër e OJQ-ve veprojnë me më pak se 10,000 euro në vit (23%).

Organizatat e shoqërisë civile janë bërë akterë të rëndësishëm në skenën zhvillimore të vendit sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, dhe implementimit të programeve të zhvillimit për grupet më të marginalizuara. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në Kosovë është përgjegjëse për organizimin e ofrimit dhe zhvillimit të shërbimeve sociale dhe familjare në vend. Aktualisht janë 49 organizata joqeveritare të licencuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e transformuar më vonë në Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve për të ofruar shërbime sociale dhe familjare². Fushëveprimi i këtyre organizatave dhe objektivi i tyre janë grupet e cënueshme të shoqërisë, kryesisht viktima të dhunës në familje, të trafikimit, persona me nevoja të veçanta, fëmijë pa prindërore dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Platforma CiviKos po lehtëson procesin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë në implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023)³. Strategjia përcakton objektivat dhe politikat strategjike që Qeveria e Kosovës synon t'i arrijë në periudhën e ardhshme afatmesme, për të përmirësuar mjedisin që të jetë më i favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile dhe për të krijuar parakushte për bashkëpunim më efektiv të organeve qeveritare dhe shoqërisë civile në proceset kyçe të reformave në vend. Kjo Strategji është hartuar për të ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile në kuadrin e katër objektivave strategjikë në vijim: **1) Sigurimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit; 2) Krijimi i një sistemi për organizatat e shoqërisë civile në kontraktimin e shërbimeve publike; 3) Vendosja e sistemit financiar dhe përcaktimi i kriterëve për mbështetjen e shoqërisë civile me fonde publike; dhe 4) Promovimi i një qasjeje të integruar për zhvillimin e vullnetarizmit në vend.**

2.1 POLITIKAT DHE KORNIZA LIGJORE

Rregullorja e Ministrisë së Financave numër 04/2017⁴ përcakton Kriteret, Standardet dhe Procedurat për financimin publik të Organizatave Jo-Qeveritare, me qëllim të krijimit të një sistemi transparent dhe llogaridhënës, për financimin me fondet publike të programeve dhe projekteve të organizatave jo-qeveritare që kanë të bëjnë me interesin publik në Kosovë.

Neni 3, paragrafi 1.6 i kësaj rregulloreje thotë se “Përfitues nënkupton OJQ-në e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatat jo-qeveritare, ose organizatat dhe partnerët e tjerë që janë kontraktuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.”

Ligji 01/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë në Kosovë. Neni 1, paragrafi 1.2 thotë se “Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut...”

¹ <https://www.kcsfoundation.org/wp-content/uploads/2018/12/Indeksi-Kosovar-i-Shoq%C3%ABris%C3%AB-Civile-2018.pdf>

² Takimi me përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

³ http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_Alb_815880.pdf

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

Në përputhje me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare⁵, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përgjegjësinë e përgjithshme të organizoj ofrimin e shërbime sociale dhe familjare në Kosovë nga organizatat joqeveritare, duke përfshirë strehimoret. MPMS është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, hartimin e legjislacionit, të standardeve dhe planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për popullatën e Kosovës, si dhe zbatimin e duhur të politikave nga komunat dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

MPMS, përmes Departamentit të saj për Mirëqenien Sociale, është përgjegjëse për licencimin e OJQ-ve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Procesi i licencimit të OJQ-ve është zhvilluar më tej në *Udhëzimin e ri Administrativ për Licencimin e Organizatave Jo-qeveritare dhe Personave Juridik Privatë që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare*⁶. Udhëzimi administrativ përcakton procedurat e aplikimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë organizatat jo-qeveritare dhe personat juridikë privatë, të cilët nuk janë përfshirë në udhëzimin e mëparshëm administrativ, për t'u licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përmes shërbimeve të financuara nga qeveria. Siç specifikohet në dokument, procesi realizohet nga Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, i cili është autoriteti përgjegjës për ruajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe organ i regjistrimit dhe licencimit të profesionistëve që janë duke punuar në këtë fushë.

2.2 PROCESI I LICENCIMIT DHE PRAKTIKAT E FINANCIMIT PUBLIK PËR OSHC-të

Përmes mbështetjes financiare të organizatave jo-qeveritare të licencuara, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale synon të rrisë disponueshmërinë, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale dhe të zgjerojë ofrimin e shërbimeve për personat që jetojnë në rrezik të përjashtimit social. Kategoritë që përfitojnë janë komunitetet e cënueshme, veçanërisht fëmijët dhe të rriturit në nevojë, personat e cënueshëm dhe të përjashtuar, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe të moshuarit. Periudha e implementimit të projektit, e lejuar nga MPMS është nga 6 deri në 12 muaj. Në fund, duhet të theksohet se thirrjet publike për grante në shërbimet sociale dhe familjare janë të hapura vetëm për OJQ-të e licencuara dhe jo për subjektet afariste, edhe pse ato kalojnë një proces shumë të ngjashëm licencimi.

Deri në mars të vitit 2022, kemi 52 OJQ të licencuara nga MPMS, bazuar në udhëzimin e ri administrativ nr. 02/2020 për licencimin e organizatave jo-qeveritare dhe personave juridikë privatë që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Në lidhje me shpërndarjen e fondeve për OJQ-të, sa i përket pandemisë, gjatë kësaj kohe nuk ka pasur asnjë pauzë gjatë kësaj periudhe me shpërndarjen e fondeve për organizatat ofruese të shërbimeve.⁷ Në vitin 2021 ishin 39 OJQ që përfituan nga këto fonde publike, përmes thirrjeve të rregullta për propozime.

Sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ri administrativ, OJQ-të mund të aplikojnë, ose të jenë partnerë në vetëm një projekt të kësaj thirrjeje. Është e rëndësishme të theksohet se periudha e zbatimit të projektit ishte 6 deri në 12 muaj. **Duke marrë parasysh që këto projekte janë vetëm afatshkurtra, do të thotë që ofruesit e shërbimeve nuk mund të garantojnë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve për përfituesit në një afat të gjatë.** Prandaj, është e paqartë se si do të vazhdohet me ofrimin e këtyre shërbime ndaj përfituesve nëse OJQ-të nuk kanë mundësi financiare për ta bërë këtë. Përveç kësaj, OJQ-të nuk kanë një stimulim për të investuar në një shërbim financimi për të cilin mund të përfundojë shumë shpejt.

Për këtë vit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka bërë thirrje publike⁸ për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në shërbimet sociale dhe familjare. Thirrja u publikua në fund të dhjetorit 2021 dhe përfundoi më 21 janar, 2022. Vlera totale e planifikuar e kësaj thirrje është 1,000,000 euro (1 milion euro). OJQ-të kishin mundësi të aplikojnë me projekte për implementimin e objektivave dhe aktiviteteve në vijim: **(1) shërbimet rezidenciale dhe të kujdesit ditor për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, të abuzuar dhe të neglizhuar, dhe (2) shërbimet rezidenciale dhe të kujdesit ditor për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit.** Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të sigurohej për një projekt ishte 30,000 euro,

5 https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/369_430_EN_original.pdf

6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=36039>

7 Takimi me Ylber Kokollarin, Zyrтарin për Licencim pranë Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjare

8 <https://mpms.rks-gov.net/en/wpdm-package/thirrje-publike-per-mbeshtetje-te-ojq-ve-te-licencuara/>

ndërsa shuma maksimale për një projekt ishte 50,000 euro. OJQ-të kishin mundësi të aplikojnë me projekte për implementimin e objektivave dhe aktiviteteve në vijim: **(1) Shërbimet alternative për fëmijët pa kujdes prindëror dhe këshillim për familjet kujdestare, për implementimin e programit për strehim familjar dhe (2) Shërbimet rezidenciale, ditore dhe në familje për të moshuarit dhe pa përkujdesje familjare.** Shuma minimale e mbështetjes për një projekt ishte 10,000 euro, përdërisa shuma maksimale për një projekt ishte 30,000 euro.

Në vitin 2021, 39 OJQ përfituan nga skema e granteve (bazuar në thirrjen e hapur për propozime e cila u hap në dhjetor 2021), duke përfshirë dhjetë strehimore (tetë strehimore për viktimat e dhunës në familje dhe dy strehimore për viktimat e trafikimit) dhe 29 OJQ. Në vitin 2022, 44 OJQ përfituan nga grantet. Zakonisht, pjesa kryesore e buxhetit shkon për strehimoret për viktimat e dhunës në familje. Nga numri i përgjithshëm i OJQ-ve përfituese, janë mbështetur 10 strehimore, në vlerë prej 400,000 euro; ku shuma më e vogël ishte 35.000 euro, ndërsa shuma më e madhe 45.000 euro. Pjesa tjetër e përfituesve ishin 34 OJQ, të cilat përfituan shumën prej 600 mijë euro, ku shumat e granteve kanë qenë prej 15 mijë deri në 25 mijë euro.

Për të kuptuar se si funksionon procesi i financimit të OJQ-ve për shërbimet sociale dhe familjare në ministritë, u organizua një takim edhe me një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë - Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor.⁹ Ministria e Shëndetësisë filloi në vitin 2018 duke mbështetur OJQ-të që ofrojnë edukim shëndetësor dhe aktivitete promovuese për komunitetet më të cënueshme. Iniciativa vazhdoi deri në vitin 2019. Megjithatë, ajo u ndërpre për shkak të pandemisë COVID-19 pasi fondet duhej të devijoheshin për të luftuar pandeminë COVID-19. Në vitin 2018, organizatave iu shpërnda një buxhet prej 400 mijë eurosh dhe fondet kanë qenë prej 1500 euro deri në 99 mijë euro. Për dallim, në vitin 2019 ka pasur një buxhet të vogël prej 150 mijë eurosh dhe në total nga kjo thirrje kanë përfituar 22 organizata. **Ministria e Shëndetësisë, për dallim nga MPMS, nuk ka sistem të licencimit të OJQ-ve, pjesërisht për shkak të mungesës së organizatave profesionale që mund të ofrojnë shërbime shëndetësore.** Megjithatë, është në interes të Ministrisë së Shëndetësisë që në të ardhmen të angazhojë organizata joqeveritare potenciale për të ofruar shërbime vaksinimi, kryesisht përmes ngritjes së vetëdijes së popullatave të cënueshme, parandalimit të sëmundjeve dhe menaxhimit të sëmundjeve kronike.

⁹ Takim me Filloreta Gashin, Zyrtare në Departamentin për Zhvillim Strategjik Shëndetësor

Qëllimi i anketës është të identifikojë dhe analizojë sfidat dhe nevojat e organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për përfituesit e tyre. Anketa mbledhi informata mbi strukturën, personelin dhe buxhetin vjetor të OJQ-ve. Më konkretisht, ai ka mbuluar financimin nga shteti për shërbimet sociale dhe pandeminë COVID-19 dhe ndikimin e tij në shërbime dhe financim.

3.1 TË DHËNAT PËRSHKRUESE

Komunat ku punojnë organizatat




Figura 1. Shpërndarja e punës së organizatës në komuna

Sa i përket fushëveprimit të punës, shumica e organizatave kishin një fushë të gjerë pune, jo të përcaktuar mirë, me përjashtim të organizatave nacionale.¹⁰, të cilat janë të pozicionuara mirë për të ofruar shërbime specifike për përfituesit e tyre. Kjo vjen edhe nga nevoja që organizatat të jenë konkurruese në marrjen e fondeve nga donatorët, duke lënë kështu të hapura mundësitë dhe fushëveprimin e punës në mënyrë që të kualifikohen për shumicën e fondeve të donatorëve.

Fushëveprimi i punës së organizatës	Numri
Ofrimi i mbështetjes për fëmijët që janë në rrezik për të humbur kujdesin prindëror ose ata që kanë humbur kujdesin prindëror	1
Ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara	10
Shërbime psikosociale për të moshuarit, pa përkujdesje familjare dhe fëmijë me nevoja të veçanta	1
Mbrojtja e të drejtave të njeriut, fuqizimi i komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptiane	2
Shërbime sociale ditore për fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta	1

10 Organizatat kombëtare janë ato që punojnë në nivel kombëtar dhe selitë e tyre janë në Prishtinë.

Shërbime psikosociale për të rinjtë që abuzojnë me drogën	2
Shërbimet rehabilituese	2
Shërbimet e strehimit, mjekësore, ligjore dhe të riintegrit	1
Shërbimet e strehimit dhe riintegrit për gratë e mbijetuara të dhunës në familje	5
Shërbime rezidenciale për fëmijët në nevojë (mbrojtje sociale)	2
Ofrimi i shërbimeve për personat e verbër	1
Shërbime psikosociale për fëmijët në kujdestari alternative	1
Shërbime psikosociale, logopedi për fëmijët me nevoja të veçanta	1
Mbrojtje sociale	1
Mbështetje për njerëzit me sindromën down	1
Mbrojtja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore	1
Shërbime psikosociale për njerëzit në nevojë	1
Mbrojtja e fëmijëve	1

Tabela 1. Fushëveprimi i punës së organizatës

Shumica e organizatave pjesëmarrëse në hulumtim kishin më shumë se 20 vjet përvojë pune (19), pasuar nga 11-20 vjet përvojë (15) dhe 6-10 vjet përvojë (1).

Numri mesatar i personelit që punon me orar të plotë është në mes 4 dhe 78. Megjithatë, për shumicën e organizatave pjesëmarrëse (23 organizata), numri mesatar i personelit që punon me orar të plotë është nga katër deri në dhjetë punonjës.

Në të njëjtën kohë, numri mesatar i personelit që punon me orar të pjesshëm për shumicën e organizatave (25 organizata) bie në mes të një dhe tetë nga personeli. Së fundi, numri mesatar i vullnetarëve për organizatat bie në mes të një dhe 76, gjysma e tyre kanë nga një deri në gjashtë vullnetarë. Shumica e organizatave pjesëmarrëse në këtë anketë kishin një buxhet prej mbi 60,000 euro. Krahasuar me organizata të tjera të vogla, të cilat kanë një buxhet më të vogël se 60,000 euro, këto janë relativisht të pozicionuara dhe të konsoliduara në ofrimin e shërbimeve.

Cili ishte buxheti vjetor i organizatës suaj në vitin 2021?




Figura 2. Cili ishte buxheti vjetor i organizatës në vitin 2021

3.2 FINANCIMI SHETETËROR PËR SHËRBIMET SOCIALE

Pjesa e parë e këtyre gjetjeve do të fokusohet në prezantimin se si organizatat e financojnë ofrimin e shërbimeve të tyre, nëse marrin mbështetje nga qeveria, dhe natyrën e kësaj mbështetje. Për më shumë, përshkruan nëse ato janë financiarisht të qëndrueshme, sa jetik është financimi i qeverisë për mbijetesën afatgjatë të organizatës dhe rekomandimet e tyre për mënyrën më të mirë që qeveria t'i mbështesë ato në të ardhmen.

Në pyetjen “Si e financon organizata juaj ofrimin e shërbimeve”? Tre burimet kryesore të financimit për organizatat ishin:

- 1) Përmes fondeve nga donatorët ndërkombëtarë;
- 2) Përmes fondeve nga qeveria kombëtare, dhe;
- 3) Përmes fondeve të pushtetit lokal.

Nuk kishte dallime të mëdha në mes të organizatave kombëtare dhe lokale në këtë drejtim.

Megjithatë, një numër i vogël i organizatave kanë raportuar gjithashtu se sigurojnë fonde nga burime të tjera si përmes: fondeve nga donatorët lokalë, nga OJQ-të dhe fondacionet (4), përmes fondeve nga donacionet individuale (1), fonde nga donacionet e korporatave (2), fondet nga aktivitetet e tjera ekonomike të gjeneruara nga vet organizata (4), tarifat e paguara nga klientët për shërbimet e ofruara (1).

Aktualisht, 29 nga 35 organizata marrin mbështetje nga qeveria; megjithatë, vetëm njëra prej tyre ka deklaruar se mbështetja e tyre është e mjaftueshme. Nga ato që marrin mbështetje dhe i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, 1) njëzet organizata raportuan se mbështetja është në formën e një granti afatshkurtër, 2) gjashtë organizata raportuan se kanë marrë një grant institucional dhe pesë prej tyre përfitojnë nga ofrimi i hapësirave të zyrës pa pagesë qiraje. Në pyetjen “Si do ta përshkruanit natyrën e mbështetjes së qeverisë për organizatën tuaj”, figura 3, ofron informata të detajuara mbi përgjigjet e pjesëmarrësve.

Si do ta përshkruanit natyrën e mbështetjes së qeverisë për
organizatën tuaj?




Figura 3. Si do ta përshkruanit natyrën e mbështetjes së qeverisë për organizatën tuaj?

Sa i përket qëndrueshmërisë së tyre financiare, në planin afatgjatë, 25 OJQ raportuan se nuk ishin financiarisht të qëndrueshme për të ofruar shërbimet e nevojshme për përfituesit në afat të gjatë, ndërsa vetëm pesë prej tyre i konsiderojnë organizatat e tyre si financiarisht të qëndrueshme. Të gjitha këto pesë organizata kanë një buxhet vjetor mbi 60,000 euro.

Për ata që kanë raportuar se nuk janë të qëndrueshëm financiarisht dhe i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, katërmbëdhjetë (14) prej tyre kanë raportuar se do të mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime për përfituesit për afërsisht 7-12 muaj, shtatë (7) prej tyre raportuan se do të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime për afërsisht 1-2 vjet, katër (4) prej tyre për afërsisht 3-6 muaj dhe dy (2) më pak se tre muaj.

Në pyetjen “**Sa jetik është financimi i qeverisë për mbijetesën afatgjatë të organizatës suaj**”? Shumica e tyre (31) u përgjigjën se është jetike; pa mbështetjen e qeverisë, ato nuk do të mund të mbijetojnë në aspektin afatgjatë, ndërsa vetëm dy organizata raportuan se financimi i qeverisë nuk është jetik, por do të kontribuonte shumë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të tyre. Rekomandimet e organizatave ofruese të shërbimeve se cila është mënyra më e mirë që qeveria të mbështesë organizatat janë përmes kontratave afatgjata, ku qeveria i kontraktton ato për të ofruar shërbime specifike për përfituesit (30 organizata), si dhe grante afatgjata institucionale (5 organizata).

3.3 PANDEMIA E COVID-19 DHE NDIKIMI I SAJ NË SHËRBIME DHE FINANCIM

Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, shumica e organizatave (30) kanë raportuar rritje të kërkesës për shërbime, ndërsa pesë (5) prej tyre nuk raportuan asnjë ndryshim në kërkesën për shërbime. Figura 4 tregon përgjigjet nga pjesëmarrësit.

Si ndikoi pandemia e Covid-19 në financimin tuaj nga qeveria?




Figura 4. Si ndikoi pandemia COVID -19 në financimin tuaj nga qeveria?

Lidhur me pyetjen “**Cilat janë kërcënimet kryesore për organizatën tuaj për shkak të kufizimeve të COVID-19?**” Figura 5 tregon përgjigjet, ku si e para – mundësia e kufizuar për të ofruar shërbime – renditet si kërcënim më i rëndësishëm. Siç tregohet, kapaciteti i kufizuar për të ofruar shërbime lidhet me informatat kthyesë të organizatave se ka pasur një rritje të kërkesave të përfituesve për shërbime.

Kërcënimet kryesore për organizatën tuaj për shkak të kufizimeve të Covid-19 (kërcënimi i parë më i rëndësishëm)




Figura 5. Kërcënimet kryesore për organizatën tuaj për shkak të kufizimeve të COVID -19

Siç tregohet në Figurën 5, më shumë se gjysma e organizatave e konsiderojnë mundësinë e kufizuar për të ofruar shërbime si kërcënimin kryesor për organizatën e tyre për shkak të kufizimeve të COVID-19. Në këtë aspekt nuk kishte dallime në mes të organizatave me buxhete të ndryshme vjetore.

Është e rëndësishme të theksohet se në kuadër të Pakos Emergjente të Qeverisë së Kosovës për Asistencën në trajtimin e pasojave të pandemisë COVID-19, jo të gjitha organizatat joqeveritare kishin të drejtë të përfitojnë. Në bazë të sqarimeve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, “punëdhënësi i cili ka personel me kontrata pune dhe po përballlet me vështirësi si rezultat i masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mund të përfitojë nga pakoja emergjente. Kjo vlen edhe për OJQ-të (Organizatat Joqeveritare) që kanë pësuar zvogëlim të ardhurave të tyre si rezultat i kufizimeve të vendosura nga qeveria, por nuk mund të zbatohen

për ato OJQ që operojnë në projekte të financuara nga donatorët, financat e të cilave nuk janë prekur nga masat apo vendimet e qeverisë¹¹.

Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, shumica e organizatave kanë zgjeruar grupin e tyre të synuar të përfituesve (20 prej tyre), dhjetë (10) prej tyre janë ende duke punuar me grupin e tyre origjinal të përfituesve. Ndryshe nga ato, një organizatë ka ngushtuar grupin e përfituesve.

Në pyetjen, “Çfarë lloj të mbështetjes ju nevojitet për të vazhduar punën sipas kufizimeve aktuale të COVID -19?”, shumica e organizatave raportuan se kanë nevojë për mbështetje financiare. Figura 6 tregon përgjigjet e vlerësuara si më të rëndësishme nga organizatat pjesëmarrëse.




Figura 6. Çfarë lloj mbështetjeje ju nevojitet për të vazhduar punën sipas kufizimeve aktuale të COVID -19?

Situata e pandemisë COVID-19 përfaqëson një kërcënim për qëndrueshmërinë afatgjatë të organizatave, ndonjëherë për shkak të humbjes së fondeve të donatorëve si rezultat i fondeve të devijuara për të luftuar pandeminë COVID-19. Ndikimi i humbjes së fondeve nga donatorët duhet të hulumtohet më tej. Megjithatë, rrethanat gjithashtu ofruan mundësi për organizatat, si ide të reja projektesh, dukshmëri më të mirë të punës së tyre, përmirësim të imazhit dhe besim më të lartë në mesin e përfituesve në punën e tyre, ndër të tjera.

Figura 6 ofron informata të detajuara mbi përgjigjet e organizatave ndaj kësaj pyetjeje.




Figura 7. Cilat janë mundësitë që dalin nga pandemia COVID-19?

3.4 GJETJET NGA PUNËTORIA E VËRTETIMIT

Për të vërtetuar (konfirmuar) gjetjet e hulumtimit që plotësojnë raportin përfundimtar me akterët kryesorë, u organizua një punëtori më 22 shkurt, 2022 në Prishtinë. Shtatë organizata morën pjesë në punëtori. Punëtorja filloi me prezantimin e gjetjeve preliminare, e pastaj përmes diskutimit u nxorën rekomandime nga organizatat.

Ky seksion u organizua rreth 3 temave dhe ne i kemi përmbledhur komentet dhe sugjerimet kryesore në vijim:

¹¹ Shpjegimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2,168>

- 1) Sfidat aktuale të financimit të qeverisë për organizatat që ofrojnë shërbime,
- 2) Pandemia e COVID-19 dhe ndikimi i saj në shërbime dhe financim, dhe
- 3) Mundësitë që dalin nga pandemia COVID -19

1) Sfidat aktuale të financimit të qeverisë për organizatat që ofrojnë shërbime

- Sfida e parë e dhënies së fondeve qeveritare për organizatat ofruese të shërbimeve janë vonesat që karakterizojnë këtë proces. Shumë organizata që përfitojnë nga fondet e qeverisë përballen me procedura të ngadalta burokratike, të cilat shpesh shoqërohen me vonesa në transferimin e fondeve.
- Nuk ka dallime në financimin e qeverisë për organizatat në varësi të vendbanimit dhe fushëveprimit të tyre, p.sh. organizata me seli në Prishtinë merr të njëjtën shumë të fondeve si dega e saj në Deçan, edhe pse numri i përfituesve për organizatën në Prishtinë është dukshëm më i lartë, si edhe sfidat janë unike.
- Organizatat duhet të aplikojnë çdo vit në thirrjen qeveritare për financim dhe kjo shkakton probleme për organizatat, pasi që fondet nuk janë të sigurta dhe si rrjedhojë nuk mund ti planifikojnë aktivitetet për vitin vijues.
- Organizatat që aplikojnë për licenca, të cilat më pas kualifikohen për financim, nuk ju licencohen programet, por vetëm ato si organizata. Perceptohet si një proces i padrejtë konkurrues nga organizatat e themeluara rishtazi, të cilat mund të mos jenë të licencuara. Duke qenë se licenca jepet për organizatën e jo për programin, kjo e bën procesin e konkurrencës të padrejtë dhe përjashton organizatat e reja që mund të ofrojnë programe adekuate dhe të kualifikuara për të ofruar shërbime specifike.
- Kontratat e nënshkruara në mes të qeverisë dhe organizatave nuk ndjekin gjithmonë logjikën e shërbimeve të kontabilitetit për kokë banori.
- Mungesa e donacioneve dhe financave të qëndrueshme ka krijuar problem në ofrimin e shërbimeve për kategori të veçanta përfituesish, siç janë fëmijët pa kujdes prindëror.
- Nuk ka një sistem adekuat të përdorimit të instrumenteve të standardizuara për monitorimin dhe vlerësimin e programeve për organizatat që përfitojnë nga financimi i qeverisë. Shërbimet sociale të ofruara nga organizatat duhet të monitorohen nga afër dhe performanca e tyre të vlerësohet periodikisht në mënyrë që organizatat të punojnë në përmirësimin e shërbimeve të tyre.

2) Pandemia e COVID -19 dhe ndikimi i saj në shërbime dhe financim

- Është raportuar për rritjen e rasteve të dhunës në familje në të gjitha komunat. Kjo ka qenë sfiduese për organizatat (kryesisht strehimoret e viktimave të dhunës në familje) që ofrojnë shërbime për këtë kategori përfituese.
- Një numër i konsiderueshëm organizatash u përballën me sfida të mbulimit financiar të personelit dhe shpeshherë personeli ka punuar në baza vullnetare.
- Në shumë organizata, veçanërisht ato që punojnë me gra viktime të dhunës në familje dhe fëmijë pa kujdes prindëror, vëllimi e punës gjatë pandemisë është rritur dhe sfidat ishin të paparashikueshme.
- Puna online ka qenë gjithashtu një sfidë në vete. Jo të gjitha organizatat kanë qenë në gjendje të përshtaten me sistemin e ri të punës online. Kjo pasi disa prej tyre duhet të takojnë përfituesit ose t'i vizitojnë në vendet ku jetojnë.
- Sfidat e organizatave që punojnë me fëmijët e privuar të familjeve të varfra, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për t'u lidhur me klasat/ mësimin online.
- Organizatat shpesh duhet të përshtaten me kushtet e reja të punës dhe të zgjerojnë

fushëveprimin e tyre të punës. Për shembull, shumë organizata kanë ofruar gjithashtu mbështetje administrative dhe logjistike për përfituesit e tyre në plotësimin e dokumenteve për financimin nga qeveria, pjesë e Pakos Fiskale Emergjente, duke përfshirë sigurimin e hapësirës për përfituesit dhe përdorimin e hapësirës së zyrës si qendër për mbledhjen e rrobave, ushqimeve, dhe mallra të tjera.

- Sipas shumë rregullave/kritereve të vendosura nga qeveria gjatë pandemisë, organizatat jo-qeveritare nuk kanë qenë të kualifikuara për Pakon Fiskale Emergjente të ofruar nga Qeveria.
- Nevoja për të ndërtuar plane të reagimit ndaj emergjencave gjatë situatave emergjente
- Procedurat Standarde të Veprimit - të paktën të krijohet një linjë e reagimit ndaj emergjencave që mund të shërbejë si një udhëzues i përgjithshëm që organizatat e tjera mund ta pranojnë.
- Kishte vonesa në proceset e aplikimit për të mbijetuarit e dhunës seksuale nga periudha e luftës. Gjatë pandemisë, komisioni i verifikimit nuk u mbledh rregullisht dhe për pasojë pati vonesa të mëdha në procesin e aplikimit për statusin e përfituesit si të mbijetuarit e dhunës seksuale.

3) Mundësitë që dalin nga pandemia COVID -19

- Kishte fleksibilitet nga donatorët për t'iu përshtatur situatës së re. Shërbimet u konvertuan në shërbime emergjente dhe kredibiliteti i organizatës u rrit. Përveç kësaj, disa organizata kanë përjetuar kthimin e fondeve të donatorëve pas tërheqjes së mbështetjes për Kosovën tash e disa vite.
- Shumica e organizatave e kuptuan potencialin e tyre për t'iu përshtatur situatave të reja dhe për të ofruar shërbime për përfituesit pa vonesa të konsiderueshme.
- Organizatat përjetuan rritje të kapaciteteve të personelit për të përdorur teknologjinë dhe mjetet online për të arritur, ndër të tjera, te përfituesit. Për më tepër, ka pasur rritje të vullnetarizmit në mesin e personelit dhe fleksibilitet në oraret e reja të punës.
- Ka pasur mobilizim të burimeve dhe rritje të bashkëpunimit në mes të organizatave dhe komuniteteve për të ofruar shërbime për përfituesit.
- Shumica e organizatave kanë raportuar imazh të përmirësuar dhe besim më të lartë në organizata si nga donatorët ashtu edhe nga përfituesit.
- Së e fundit, organizatat kanë raportuar se kanë pasur mbështetje më të madhe nga donacionet private (filantropia).

HARTËZIMI I ORGANIZATAVE QË OFROJNË SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

HARTËZIMI I ORGANIZATAVE QË OFROJNË SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Në këtë seksion, organizatat do të ndahen në disa kategori duke filluar nga: **(1) organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit; (2) organizatat që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror; 3) organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare jo rezidenciale; 4) organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rriturit me nevoja të veçanta; 5) organizatat që ofrojnë shërbime kryesisht për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian; 6) organizatat që kanë një fushëveprim paksë të ndryshëm.**

Ky hartëzim i praktikave ekzistuese bazohet në rishikimin e hulumtimeve ekzistuese, rishikimin e llojit të mbështetjes që OJQ-të u kanë ofruar përfituesve të tyre gjatë pandemisë COVID-19, nevojat specifike në kontekstin e pandemisë dhe llojin e ndihmës që ata morën nga Qeveria e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve. Seksioni i mëposhtëm synon të hartëzojë/pasqyroj peizazhin e organizatave dhe shërbimeve që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në mesin e organizatave të licencuara nga MPMS.

Ky seksion hartëzimi është i ndarë në pjesë të ndryshme. Pjesa e parë ofron informacion kontekstual mbi masën në të cilën OJQ-të janë aktive në ofrimin shërbimeve sociale dhe sociale familjare dhe shpërndarjen e përgjegjësisë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në mes të niveleve të ndryshme të qeverisjes. Ky studim vëri në pah situatën dhe nevojat e identifikuara në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

4.1 STREHIMORET PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË DHE OFRUESIT E TJERË TË SHËRBIMEVE REZIDENCIALE

Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës së pandemisë janë shtuar rastet e dhunës në familje. Policia e Kosovës ka bërë të ditur se në vitin 2021 janë raportuar 2198 raste të dhunës në familje, ku 1744 kanë qenë gra dhe 498 burra, viktimat të dhunës në familje. Në kontrast, në vitin 2020 janë raportuar 2069 raste të dhunës në familje (1636 gra dhe 433 burra), ndërsa në vitin 2019 janë raportuar 1915 raste të dhunës në familje (1593 gra dhe 385 burra). Nevoja për të mbështetur dhe integruar viktimat e dhunës në familje është thelbësore për viktimat.

Strehimoret për viktimat e dhunës në familje ofrojnë shërbime mbështetëse që mundësojnë mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave dhe janë treguar të jenë efektive për të ndihmuar gratë të largohen nga marrëdhëniet abuzive. Aktualisht janë tetë strehimore për gra në Kosovë me lokacione në Gjakovë, Ferizaj, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Prizren dhe Mitrovicë Jugore. Strehimorja e tetë gjendet në Novobërdë.¹²

Strehimoret për gratë dhe fëmijët viktimat të dhunës në familje ofrojnë strehim, veshje, ushqim, rehabilitim, kontroll mjekësor dhe shërbime psiko-sociale për gratë dhe fëmijët e tyre (deri në moshën 12 vjeç për djemtë). Shumica e strehimoreve kanë funksionuar që nga viti 2000, menjëherë pas luftës në Kosovë, të themeluara me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Numri mesatar i personelit që punonte me orar të plotë për këto organizata ishte shtatë, ndërsa numri mesatar i personelit që punonte me orar të pjesshëm ishte tre. Numri i vullnetarëve të angazhuar ishte shumë i ulët. Nga tetë organizatat, vetëm tre kanë pasur vullnetarë në vitin 2021. Strehimoret e grave dhe fëmijëve kanë përafërsisht një buxhet vjetor prej 41,000 – 60,000 euro.

Sa i përket financimit shtetëror për shërbimet e tyre, ata të gjithë përfitojnë nga thirrja publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara nga MPMS në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Më specifikisht, strehimoret përfitojnë nga pjesa më e madhe e buxhetit të akorduar për këtë thirrje, nisur nga ndjeshmëria e nevojave të përfituesve të shërbimeve të tyre.

Përveç mbështetjes së marrë nga financimet e qeverisë, strehimoret financojnë ofrimin e shërbimeve

12 Strehimorja e Novobërdes - Zenski Inkluzivni Centar, është licencuar që nga viti 2018, një vit licencë për herë të dytë pas rilicencimit trevjeçar 27.12.2019 deri më 26.12.2022 dhe pas rilicencimit të dytë me udhëzim të ri nga data 17.12.2021 deri 16.12.2024.

të tyre përmes fondeve të donatorëve ndërkombëtarë, të ndjekur nga pushteti lokal, kryesisht në formën e hapësirave për zyra pa pagesën e qirasë dhe shërbimet komunale. Mbështetja e marrë nga qeveria është e rregullt, gjë për të cilën ata duhet të aplikojnë çdo vit përmes një procesi të hapur konkurrues. Megjithatë, qëndrueshmëria e tyre financiare është e rrezikuar. Financat e tyre janë të pamjaftueshme për të vazhduar ofrimin e shërbimeve për përfituesit në aspektet afatgjate. Për të trajtuar këtë boshllëk, rekomandohet nga ana e organizatave që qeveria t'i mbështetë ato në formën e kontratave afatgjate.

Sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19, organizatat kanë raportuar një rritje të numrit të kërkesave për shërbime. Përkundër kësaj, përveç financimit të rregullt të marrë nga qeveria, asnjë nga organizatat nuk ka marrë fonde shtesë për t'u përballur me këtë situatë. Përndryshe, shumica prej tyre konsiderojnë se kanë hasur në mirëkuptimin e donatorëve ndërkombëtarë, të cilët ju kanë mundësuar rialokimin e mjeteve dhe me këtë ju kanë mundësuar plotësimin e nevojave specifike gjatë pandemisë.

Organizatat e kanë të pamundur të veprojnë nga distanca për shumicën e shërbimeve të tyre, duke pasur parasysh natyrën e punës së tyre. Në emergjencën e tilla si COVID-19, organizatat do të kenë nevojë për mbështetje financiare dhe ndërtim kapacitetesh që personeli të përdorë veglat që gjenden online. Megjithatë, disa nga mundësitë që kanë lindur nga COVID-19 ishin ide të reja projektesh, imazh i përmirësuar dhe besim më i madh në punën e tyre. Më shumë informata për çdo organizatë individuale gjenden në Shtojcën 1 të këtij raporti, fushëveprimi i tyre i punës, struktura e tyre organizative, financat, qëndrueshmëria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në funksionimin e tyre të përgjithshëm.

4.2 ORGANIZATAT QË OFROJNË SHËRBIME REZIDENCIALE PËR FËMIJËT NË NEVOJË

Ky grup organizatash përfshin ato që fokusi kryesor i tyre është ofrimi i shërbimeve rezidenciale për fëmijët e braktisur, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët familjet e të cilëve nuk janë në gjendje të kujdesen për ta dhe fëmijët në rrezik për të humbur kujdesin prindëror. Në kuadër të MPMS-së janë të licencuara vetëm dy organizata jo-qeveritare që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë. Organizata e vetme që ofron shërbime rezidenciale për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror ose janë në rrezik të humbasin kujdesin prindëror që nga lufta është "SOS Fshati". Vitet e fundit, organizata ka zgjeruar fushëveprimin e saj për të ofruar shërbime për prindërit e familjeve të cenueshëm dhe nënat në rrezik për të braktisur fëmijë. Organizata tjetër e themeluar vitet e fundit, gjegjësisht në vitin 2011, është "Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve" (Hopes and Homes for Children), e cila ofron shërbime kryesisht për fëmijët e keqtrajtuar të moshës 3-18 vjeç, të cilët mund të jenë në rrezik për formë të ndryshme të trafikimit.

Edhe pse ka dallime në mes të organizatave, si në specifikat e fushëveprimit ashtu edhe në vitet e përvijës në terren, është thelbësore që organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë të kenë qëndrueshmëri financiare afatgjate. Sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19, këto organizata kanë raportuar një rritje të kërkesës për shërbime, gjë e cila nuk ka qenë gjithmonë e lidhur me fushëveprimin e organizatave (p.sh., ndihma me ushqim, veshmbathje, teknologji për fëmijët e moshës shkollore për të ndjekur online mësimet, etj.).

Është gjithashtu e rëndësishme të ceket se gjatë pandemisë COVID-19, përfituesit e këtyre organizatave ishin më sfidues për ti synuar, pikërisht për shkak të mbylljes. Personeli i këtyre organizatave ka punuar aktivisht në terren gjatë gjithë pandemisë, pasi kjo ka qenë e vetmja mënyrë për të trajtuar këtë grup fëmijësh ose për të identifikuar fëmijët që mund të jenë në rreziqet e formave të ndryshme të keqpërdorimit. Më shumë informata në lidhje me secilën nga organizatat mund të gjenden në Shtojcën 2.

4.3 ORGANIZATAT QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE JO REZIDENCIALE

Ky grup përfshin organizata që ofrojnë shërbime jo rezidenciale për kategori të ndryshme të shoqërisë, duke filluar nga organizatat që ofrojnë shërbime jo rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror (Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror), fëmijët që lypin në rrugë,

organizatat që ofrojnë çdo ditë, rregullisht shërbime jo rezidenciale për gratë viktime të dhunës seksuale të kohës së luftës dhe të mbijetuarat e torturës së luftës në Kosovë. Edhe pse me fushëveprime të ndryshme, organizatat raportuan sfida të ngjashme sa i përket qëndrueshmërisë financiare afatgjate. Është e rëndësishme të ceket se këto janë kryesisht organizata të mëdha që veprojnë në Kosovë që nga periudha e pasluftës. Dy organizata veprojnë vetëm në rajonin e Dukagjinit (Medica Kosova dhe Medica Gjakova). Organizata tjetër, "Terres des Hommes" punon në Kosovë dhe ka mbi 19 vite që vepron në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve. Kryesisht organizata udhëheq projekte për të mbrojtur më mirë fëmijët nga keqtrajtimi, neglizhenca, dhuna, delikuenca, shfrytëzimi dhe trafikimi.

Buxheti i këtyre organizatave është kryesisht mbi 60.000 euro në vit. Burimet kryesore financiare të këtyre organizatave janë fondet nga organizatat ndërkombëtare, të ndjekura nga fondet e qeverisë qendrore (MPMS) dhe fondet nga pushteti lokal.

Megjithatë, mbështetja e marrë nga qeveria konsiderohet e pamjaftueshme dhe jo e rregullt për të ofruar shërbime të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për përfituesit. Megjithatë, në këtë grup, ka organizata që e konsiderojnë veten të qëndrueshme financiarisht për të ofruar shërbime për përfituesit e tyre (Medica Gjakova dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës), si dhe fondet vijnë kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë.

Sa i përket ndikimit të pandemisë COVID -19, organizata ka pasur kërkesë të shtuar për shërbimet e tyre. Edhe pse nuk kanë marrë mbështetje shtesë nga qeveria, ato kanë gjetur mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë, të cilët kanë ofruar mbështetje dhe ndihmë për ndryshimin e destinacionit të fondeve sipas nevojës. Megjithatë, disa nga kërcënimet kryesore nga organizatat të trajtuara gjatë pandemisë janë mundësitë e kufizuara për të ofruar shërbime dhe ndonjëherë kapacitetet e kufizuara për të përmbushur nevojat e shtuara të përfituesve. Si e fundit, të gjitha organizatat panë mundësitë që dolën nga pandemia, e ato ishin idetë e reja për projekte dhe dukshmëria më mirë e punës së tyre. Më shumë informata në lidhje me secilën nga organizatat mund të gjenden në Shtojcën 3.

4.4 ORGANIZATAT QË OFROJNË SHËRBIME PËR FËMIJËT DHE TË RRITURIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Në Kosovë, shumica e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta organizohen rreth shërbimeve të ofruara nga Handikos. Kjo është një nga organizatat që ofron shërbime për më shumë se 20 vjet në vend. Organizata ka shtrirje në të gjitha qytetet e Kosovës, ku organizatat si degë, me të njëjtin emër funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe ofrojnë shërbime të specializuara për plotësimin e nevojave të personave me nevoja të veçanta në komunat përkatëse. "Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës" është themeluar në vitin 1983. Objektivi kryesorë e kësaj Shoqate ishte "përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar në Kosovë" përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Aktualisht HANDIKOS veprimtarinë e vet e zhvillon në tërë territorin e Kosovës me 13 Zyra lokale dhe 14 Qendra të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, përfshirë këtu edhe pjesën Veriore të Kosovës. HANDIKOS ka një databazë me 18,000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive, dhe etnive të ndryshme.

Nga viti 1999 e deri më sot HANDIKOS ka ofruar shërbime të rehabilitimit primar për rreth 2,900 fëmijë me aftësi të kufizuar duke ju ofruar rreth 22,500 trajtime të rehabilitimit psiko-sociale dhe primar fizikale të ofruara në çdo vit. HandiKOS ka ofruar rreth 6,300 pajisje të ndryshme ndihmëse, përfshirë këtu karrocën, kukëzat, kaprronë tualeti, material për inkontinencë, material për trajtimin e plagëve dekubitare, etj. Në mbështetje të organizatave ndërkombëtare, HandiKOS ka arritur që të përmirësojë qasjen në infrastrukturën fizike duke rregulluar 96 pjerrina në objektet publike si dhe adaptimin e ambienteve të banimit tek personat me aftësi të kufizuara. 1,550 fëmijë dhe të rritur nga e gjithë Kosova kanë përfituar nga rehabilitimi i ofruar gjatë kampeve aktive në bregdet; HandiKOS ka avokuar, lobuar dhe ka marrë pjesë në krijimin, ndryshimin dhe monitorimin e implementimit të infrastrukturës ligjore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; Përmes organizimit të fushatave të ndryshme, dokumentarëve, video prezantimeve, debateve televizive, tryezave, HandiKOS ka ngritur vetëdijen e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve për

të drejtat e tyre, përfaqësuesve të institucioneve dhe mbarë shoqërisë në Kosovë; HandiKOS ka publikuar udhëzues dhe doracak të ndryshëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke u bërë burimi i vetëm i informacionit mbi aftësinë e kufizuar në Kosovë;

HandiKOS gjatë gjithë këtyre viteve ka ngritur kapacitetet e stafit në harmoni me nevojat e personave me aftësi të kufizuara duke ju përshtatur rrethanave të kohës; HandiKOS është një nga organizatat e cila punëson më së shumti persona me aftësi të kufizuara dhe ndërmjetëson punësimin e tyre në tregun e punës duke ngritur kapacitetet e tyre; Gjate kësaj kohe HandiKOS zhvilloi kapacitetet dhe u bë partner serioz i donatoreve dhe organizatave ndërkombëtare, lokale në implementimin e projekteve, si dhe forcoj bashkëpunimin me institucione të nivelit qendror dhe lokal me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe avancimit të pozitës së personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, raporti ofron informata specifike për organizatat që synojnë grupe të caktuara të njerëzve me nevoja të veçanta, si Shoqata e të Verbërve, Down Syndrome Kosova, si dhe Qendra për Këshillim dhe Rehabilitim të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara "Floriani", dhe Qendra e Kujdesit Ditor "PEMA".

Gjë që është e përbashkët për të gjitha degët e Handikos në Kosovë është se pjesa më e madhe e financimit vjen nga qeveria qendrore, e ndjekur nga fondet nga organizatat ndërkombëtare dhe qeveria lokale. Megjithatë, edhe pse financohen nga qeveria, shumica e tyre e konsiderojnë veten të paqëndrueshëm financiarisht dhe nuk do të mund të financojnë shërbimet e tyre në aspektin afatgjatë.

Përveç rritjes së kërkesës për shërbime, këto organizata janë përballur me vështirësi në ofrimin e shërbimeve për përfituesit e tyre për shkak të mungesës së mobilitetit (të përfituesve) dhe mungesës së burimeve financiare shtesë të organizatave për të kryer vizita të rregullta në shtëpi për përfituesit në nevojë. Shumica e degëve të Handikos që kanë marrë pjesë në këtë raportim kanë raportuar se kanë një buxhet mbi 60 mijë euro.

Ashtu si Handikos, organizata të tjera përballen me sfida të ngjashme në aspektin e qëndrueshmërisë financiare. Pasi që të gjithë janë të licencuar nga MPMS dhe janë përfitues të granteve vjetore të ndara nga kjo ministri, të gjithë konsiderojnë se shumica e mbështetjes është e pamjaftueshme për të planifikuar dhe implementuar ofrimin e shërbimeve për përfituesit në afat të gjatë. Për këtë arsye, ata rekomandojnë që qeveria të fillojë t'i mbështesë me kontrata afatgjata, të cilat do të siguronin qëndrueshmëri financiare. Shumica e organizatave që ofrojnë shërbime për personat me nevoja të veçanta (të rritur dhe fëmijë) janë përballur me vështirësi gjatë pandemisë, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës për shërbime nga përfituesit. Më shumë informata në lidhje me secilën nga organizatat mund të gjenden në Shtojcën 4.

4.5 ORGANIZATAT QË OFROJNË SHËRBIME KRYESISHT PËR KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Të dhënat e fundit zyrtare për përfaqësimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë të Kosovës në Kosovë janë të regjistruara në regjistrimin e vitit 2011, që tregojnë se në Kosovë jetojnë 8,824 Romë, 15,436 Ashkali dhe 11,524 Egjiptianë të Kosovës.¹³ Kështu që, Romët e Kosovës përbëjnë 0.51 për qind të popullsisë në Kosovë, Ashkalitë e Kosovës 0.89 për qind dhe Egjiptianët e Kosovës 0.66 për qind. Megjithatë, këto të dhëna duhet shikuar me kujdes, duke marrë parasysh se regjistrimi nuk është bërë në katër komunat veriore.

Në këtë grup janë identifikuar dy organizata, njëra që punon në nivel kombëtar (Balkan Sunflowers) dhe tjetra që punon në nivel rajonal, kryesisht në rajonin e Dukagjinit (Duart Plotë Mëshirë). Përveç komponentëve për promovimin e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe promovimin e arsimit, të dyja organizatat ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për fëmijët në fushën e arsimit përmes aktiviteteve ditore. Për shembull, Balkan Sunflowers vepron në pesë qendra mësimore në katër komuna në Kosovë, ku pretendojnë se u shërbejnë përafërsisht 500 fëmijëve në ditë. Të dyja organizatat për vitin 2021 kanë raportuar një buxhet mbi 60 mijë euro. Sa i përket financimit për shërbimet e tyre, të dy organizatat kanë si burim kryesor financimin nga donatorët ndërkombëtarë, të ndjekur nga financimi i qeverisë qendrore dhe, në fund, financimi i qeverisë

¹³ <https://ask.rks-gov.net/media/2129/estimation-of-kosovo-population-2011.pdf>

lokale. Edhe pse organizatat operojnë në një gamë të gjerë aktiviteteve, ato e konsiderojnë veten jo të qëndrueshme financiarisht. Projektet janë kryesisht të shkurtra, gjë që nuk siguron qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve për një periudhë më të gjatë. Fondet e marra nga qeveria (përmes MPMS) nuk konsiderohen të mjaftueshme për të mbuluar nevojat aktuale të organizatave, aq më pak për të planifikuar ndërhyrje të qëndrueshme afatgjate. Organizatat konsiderojnë se qeveria duhet të fillojë kontraktimet përmes kontratave afatgjate për të trajtuar këtë boshllëk. Lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 në punën e tyre, të dyja organizatat raportojnë rritje të kërkesës për shërbime dhe kapacitete të kufizuara për të përmbushur nevojat e shtuara të përfituesve. Ashtu si organizatat e tjera, ato konsiderojnë se disa mundësi që kanë lindur nga pandemia ishin idetë e reja të projektit, dukshmëria më e mirë e punës së tyre, imazhi i përmirësuar dhe besimi më i lartë i përfituesve në punën e tyre. Më shumë informata në lidhje me secilën nga organizatat mund të gjenden në Shtojcën 5.

4.6 ORGANIZATAT E TJERA

Grupi i fundit i organizatave përfshinë organizatat me fushëveprim më të gjerë të punës. Fushëveprimi i tyre lidhet kryesisht me ofrimin e shërbimeve humanitare, kujdesin shëndetësor, përmirësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore, përmirësimin e pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe të drejtën për arsim dhe shërbime sociale për një grup të gjerë përfituesish. Në këtë grup përfshihet edhe organizata e specializuar e quajtur Labyrinth, e cila ofron shërbime për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin dhe reduktimin e të këqijave që lidhen me injektimin e drogës.

Të gjitha organizatat për vitin 2021 kanë raportuar një buxhet mbi 60,000 euro. Burimi kryesor i tyre janë donatorët ndërkombëtarë, të ndjekur nga financimi i qeverisë qendrore dhe lokale.

Edhe pse të gjitha këto organizata aktualisht kanë fonde të mjaftueshme për të operuar, në aspektin afatgjatë, konsiderohet se mbështetja e qeverisë është thelbësore për të mundësuar dhe siguruar ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve. Për këtë arsye, organizatat kanë rekomanduar që qeveria të krijojë mekanizma që do ti mundësonte atyre dhe organizatave të ngjashme të ofrojnë shërbime përmes kontratave afatgjate.

Pasiguria financiare është vërejtur veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, ku ka pasur rritje të kërkesave për shërbime nga përfituesit, dhe ata janë përballur me mungesë të kapaciteteve financiare për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave për shërbime dhe mungesë të infrastrukturës për të vazhduar punën në distancë. Më stabil në këtë grup të organizatave konsiderohet Caritas Kosova, i cili është i pozicionuar mirë për të ofruar shërbime. Për më tepër, kjo organizatë është ndër të paktat që ka marrë ndihmë financiare në kuadër të Pakos Fiskale Emergjente të Qeverisë. Më shumë informata në lidhje me secilën nga organizatat mund të gjenden në Shtojcën 6.

5. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Ky studim ka ofruar informata të rëndësishëm mbi sfidat e organizatave që ofrojnë shërbime, ndikimin e pandemisë COVID -19 në punën e tyre, mësimet e nxjerra, si dhe mundësitë.

Për më tepër, ka ofruar informata dhe sugjerime thelbësore që kanë dalë nga gjetjet e hulumtimit, të cilat politikë bërësit mund t'i përdorin për të përmirësuar dhe forcuar shërbimet kontraktuale me organizatat. Megjithatë, mund të nevojiten hulumtime të mëtejshme për të kuptuar kompleksitetin e secilës organizatë, ky raport tregon se organizatat, në përgjithësi, kanë sfida që janë të përbashkëta për të gjithë dhe se nuk ka dallime të mëdha në mes të tyre në mënyrën se si e shohin kontraktimin e shërbimeve nga qeveria në të ardhmen.

Vetëm një numër i vogël, pothuajse i pavërejtur i organizatave gjenerojnë të ardhura nga aktivitetet e organizatës. Siç është paraqitur në pjesën e rezultateve, shumica e organizatave janë përfituese të financimit afatshkurtër të qeverisë. Megjithatë, këto fonde konsiderohen të pamjaftueshme për funksionimin dhe qëndrueshmërinë optimale në ofrimin e shërbimeve për përfituesit. Për më tepër, shumica e organizatave raportuan se ato nuk ishin financiarisht të qëndrueshme dhe se mbijetesa e tyre varej nga mbështetja e qeverisë në afat të gjatë. Për këtë arsye, të gjitha organizatat, pa përjashtim, rekomandojnë që forma e mbështetjes së qeverisë të jetë në formën e kontratave afatgjata, ku organizatat do të kontrakttoheshin për të ofruar shërbime specifike për përfituesit.

Sa i përket ndikimit të pandemisë në shërbimet dhe financimin, gjetjet treguan se pavarësisht sfidave, shumica e organizatave raportuan se kishin marrë pak mbështetje përmes projekteve afatshkurtra. Për më tepër, ata raportuan se ishin përballur me mundësi të kufizuara për të ofruar shërbime për shkak të rritjes së numrit të përfituesve.

Shumica e organizatave raportuan se kanë nevojë për mbështetje financiare nëse vazhdojnë të punojnë nën kufizimet aktuale të COVID -19 dhe rrisin kapacitetin e personelit për të përdorur mjetet online për punë. Përfundimisht, më shumë se gjysma e organizatave raportuan se mundësitë e shfaqura nga pandemia COVID -19 janë kryesisht ide të reja projektesh, dukshmëri më të mirë, besim më të lartë dhe imazhi i përmirësuar publik. Për më tepër, këto gjetje u konfirmuan në seminarin e organizuar për të vërtetuar gjetjet e hulumtimit. Më tutje, rritja e vullnetarizmit konsiderohet si një nga mundësitë më të mira që ka dalë nga situata pandemike. Organizatat do të përpiqen ta përdorin, zhvillojnë dhe fuqizojnë këtë më tej në të ardhmen.

REKOMANDIMET

Seksioni në vijim ofron rekomandimet, të grupuara në kategori: 1) Rekomandimet për qeverinë, 2) Rekomandimet për organizatat dhe 3) Rekomandimet specifike lidhur me COVID -19.

Rekomandime për Qeverinë e Republikës të Kosovës:

- Qeveria duhet të kontrakttojë organizatat përmes një angazhimi afatgjatë, ku ato kontraktohen për të ofruar shërbime specifike sociale dhe familjare për përfituesit. Kjo duhet bërë në mënyrë që të shmangen boshllëqet në ofrimin e shërbimeve për përfituesit dhe, në të njëjtën kohë, të sigurohet qëndrueshmëria e organizatave në afat të gjatë. Sa i përket kësaj, qeveria duhet të angazhohet në dialogun social me OSHC-të për të vendosur mbi praktikën më të mira për angazhimin afatgjatë me kontratë të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
- Qeveria duhet ti ngarkojë (shpenzimet për) shërbimet për aktivitet/program në procesin e licencimit të organizatave. Tarifa e shërbimit duhet të përfshijë të gjitha elementet e nevojshme, duke përfshirë shërbimet për përfituesit, personelin, hapësirat e zyrave, pajisjet ndihmëse operacionale, etj.
- Qeveria nuk duhet të anashkalojë OSHC-të e reja të sapo krijuara, të cilat mund të ofrojnë aftësitë dhe kapacitetet për të konkurruar me shërbime të cilësisë së lartë. Ata duhet të kenë mundësi të barabarta në një proces të hapur konkurrues ose të inkurajohen që në fillim të punojnë me

organizata më të mëdha dhe më me përvojë.

- Qeveria duhet të angazhojë organizatat që të jenë pjesë e procesit të hartimit dhe planifikimit të marrëveshjeve kontraktuale afatgjata me qeverinë. Qeveria duhet të bëjë një analizë të plotë të përshkrimit të programit të organizatave që mund të jenë ofrues të mundshëm shërbimesh për grupet e veçanta të përfituesve. Për më tepër, qeveria duhet të ketë prioritet organizatat që punojnë me grupet e marginalizuara dhe të cenueshme që kanë nevojë për kujdes urgjent dhe shërbimet e të cilave nuk mund të vonohen, të tilla si të mbijetuarit e dhunës në familje, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët që punojnë në rrugë, etj.
- Financimi nga qeveria duhet të përshtatet dhe orientohet drejt mbështetjes dhe plotësimit të boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve për organizatat me kërkesë të shtuar për shërbime gjatë pandemisë. Kjo duhet të vlerësohet dhe monitorohet nga afër.
- Qeveria duhet të përcaktoj instrumentet e standardizuara për të vlerësuar kapacitetet e organizatave dhe programet e tyre për të ofruar shërbime për përfituesit. Licenca duhet të dëshmojë se organizatat duhet të paraqesin dhe posedojnë një nivel të caktuar të cilësisë. Nën këtë prag të përcaktuar, ato nuk duhet të jenë në gjendje të rinovojnë licencën dhe të kenë të drejtë për marrëveshje kontraktuale me qeverinë. Për më shumë, qeveria duhet të kërkojë një vlerësim të brendshëm të nevojave të përfituesve në fillim të ofrimit të shërbimit - dhe gjatë kësaj kohe, kur organizatat monitorojnë progresin e përfituesve, pastaj të raportojnë prapa në ministrinë e linjës.

Rekomandime për organizatat:

- Organizatat duhet të vlerësojnë vazhdimisht nevojat e përfituesve dhe, në rastet kur ka rritje të përfituesve, t'i raportojnë ato, qoftë edhe në propozimet e paraqitura në qeveri për financim.
- Organizatat duhet të krijojnë diçka të ngjashme me Procedurën Standarde të Veprimit, si të veprojnë në rastet kur ka rritje të fluksit të përfituesve. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e nevojave të personelit për të përballuar me ndryshimet e papritura dhe për të vlerësuar aftësitë e tyre për t'u përshtatur me situatën e re. Kjo lidhet ndjeshëm me punën në kohë pandemie, por jo vetëm.
- Lidhur me situatën me COVID-19, është thelbësore që organizatat të punojnë ngushtë me qeverinë në hartimin dhe planifikimin e masave mbështetëse të pandemisë COVID-19. Organizatat duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të punuar në internet (online) dhe për të ofruar shërbime për përfituesit në internet (siç është këshillimi).
- Organizatat duhet të ofrojnë një vlerësim të brendshëm dhe mbikëqyrje të shërbimeve të tyre sociale dhe familjare. Mbikëqyrja përfshin bisedat rreth ndikimit që ka puna tek organizatat dhe eksplorimin e ndikimit të saj tek përfituesit. Është jetike për organizatat, zhvillimin e tyre profesional dhe mbikëqyrjen e menaxhimit. Që është më e rëndësishme, mbikëqyrja i ndihmon organizatat të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme për përfituesit e tyre.

Rekomandime specifike që lidhen me COVID-19:

- Organizatat duhet të punojnë ngushtë me qeverinë në hartimin dhe planifikimin e masave mbështetëse të pandemisë COVID -19.
- Financimet nga qeveria duhet të përshtaten dhe drejtohen kah mbështetja dhe plotësimi i boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve për organizatat që kanë raportuar rritje të kërkesës për shërbime, të cilat duhet të vlerësohen dhe monitorohen nga afër.
- Organizatat duhet të krijojnë diçka të ngjashme si Procedurë Standarde të Veprimit, se si të veprojnë në rastet kur ka një rritje të fluksit të përfituesve në situata emergjente. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e nevojave të personelit për të përballuar me ndryshimet e papritura dhe për të vlerësuar aftësitë e tyre për t'u përshtatur me situatën e re.
- Thelbësore është që organizatat të punojnë ngushtë me qeverinë në hartimin dhe planifikimin e masave mbështetëse të pandemisë COVID -19. Organizatat duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të punuar në internet (online) dhe për të ofruar shërbime për përfituesit në internet (siç është këshillimi).

